



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

17 Mars 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

Ramadani nga Viena, njofton Agjencinë Zhurnal: Operacioni në Austri ka përfunduar me sukses, Zoti ju shpërbëleft



Shkup, 16 mars - Një lajm i gëzuar vjen nga Austria, Agjencisë së Lajmeve Zhurnal.

Vajza e Shkupit e cila vuante nga një sëmundje e rrëndë në këmbën e majtë është operuar me sukses në spitalin e Vienës. Këtë temë e senzibilizoi në opinionin për herë të parë “ZHURNAL”. Mjekët austriak kanë dhënë garanca se operacioni është kryer me sukses të madh dhe vajza nga Shkupi, tani më do të fillon të shërohet përgjithmon nga sëmundja e rrëndë e cila nuk ishte mundur të operohet në Maqedoni. Lajmin e ka bërë të ditur për Zhurnal, prindi i vajzës R.B(60) përmes një sms porosie.

“Përshëndetje, e nderuara kryesi e redaksisë “Zhurnal”. Ju informoj se operacioni ka kaluar me sukses. Prandaj Allau ka lënë Xhentin dhe xhenemin. Xheneti është për bëmirsat...Allahu ju shpërbleft me Xhenet ishalla. Të fala Ramadani, nga Viena”, shkruan prindi i vajzës.

Nga ana tjetër prindi i vajzës përmes një linje telefonike ka shpreh mirënjohje të thellë edhe ndaj drejtorit të Fondit për Shëndetësi, Orhan Ramadani për përkushtimin e tij që ti del në ndihmë vajzës nga Shkupi.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ndryshe, vuajtjet e vajzës shqiptare kishin filluara para disa vitesh, ku mjekët e Maqedonisë kishin dhënë mendim konsiliar se sëmundja e rrëndë në këmbën e majtë nuk mund të operohet në Spitalet e Maqedonisë.

Zhurnal publikoi të gjitha dokumentet e Spitaleve të vendit tonë se mjekët e Maqedonisë nuk mund të kryejnë kësi llojë operacionesh. Mirëpo edhe pse mjekët kishin dhënë mendim konsiliar që pacientja të shërohet jashtë vendit, Fondi i Shëndetësisë disa herë e kishte refuzuar kërkesën e pacientesë.

Mirëpo me senzibilizimin e rastit nga Zhurnal, Fondi për Shëndetësi e shqyrtoi edhe një herë rastin e vajzës shqiptare nga Shkupi dhe i mundësoi që me para të shtetit nga Fondi të operohet në Austri.

Ndryshe, Fondi për Shëndetësi ka buxhet prej disa miliona eurove që janë të dedikuara vetëm për operacionet e rrënda të pacientëve që nuk mund të shërohen në Maqedoni. Fondi ka 2 komisione, dhe këta antarë vendosin se një pacient a i përmbush kushtet për tu operuar jashtë Maqedonisë në pajtim me të gjitha dokumentet dhe mendimin konsiliar të tre mjekëve.

Nga ana tjetër stafi i ekipit të Agjencisë së Lajmeve Zhurnal i dëshiron shërim të shpejt vajzës nga Shkupi.

Sot do të shënohet Dita e dhuruesve të gjakut në Maqedoni

Shkup, 17 mars - Me disa aktivitete sot do të shënohet 17 Marsi Dita e dhurimit të Gjakut në Republikën e Maqedonisë.

Në Qendrën tregtare të qytetit do të vendoset tenda promovuese ku vullnetarët nga Klubi i Kryqit të Kuq i Qytetit të Shkupit dhe "Klub 25" do të ndajnë fletushka dhe do të japin informata për dhurimin e gjakut, ndërsa persona mjekësorë nga Instituti për mjekësi transfuziologjike do të përcaktojnë grupin e gjakut të qytetarëve.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



TETOVA

shpejt dhe ndryshe

Todorov: Mamografi i ri në SK – Shtip me rëndësi të madhe për pacientët e rajonit lindor



Vënia në funksion e mamografit të ri digjital në Spitalin klinik në Shtip është me rëndësi të madhe për pacientët e rajonit lindor. Këtë sot e deklaroi ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorov, i cili sot e vizitoi këtë institucion shëndetësor publik.

Theksoi se mamografi i ri digjital, i cili kushton rreth gjashtë milionë denarë dhe i cili është vendosur në Repartin për rendgenologji, e zëvendëson mamografin e vjetër analog.

“Kontrollet në mamograf tashmë janë vendosur në kuadër të ‘Terminet im’ dhe ka tre termine në javë, ndërsa dy termine janë për skringing të kancerit në gji të cilin e udhëheqim në

mënyrë të centralizuar përmes Ministrisë së Shëndetësisë. Nga ajo që mund ta konstatoj në Shtip është se vazhdimisht kemi furnizime të pajisjeve të reja ndërsa është duke u investuar në të gjitha segmentet e tjera. E dini se filluam edhe me ndërtimin e spitalit të ri klinik i cili do t’i zëvendësojë këto ndërtesa të reja dhe këtë infrastrukturë të vjetër shëndetësore”, tha Todorov.

Ai potencoi se Ministria e Shëndetësisë katër viteve të kaluara ka punuar në përforcimin dhe rritjen e personelit mjekësor në Spitalin klinik në Shtip.

Gjatë katër viteve të kaluara janë punësuar 140 mjekë, infermiere dhe infermierë, ndërsa janë ndarë edhe 30 specializime për mjekët të cilët tashmë specializojnë në degë të caktuara të mjekësisë në vend dhe jashtë vendit.

PORTALB

dritare realiteti

Sot shënohet Dita e dhuruesve të gjakut në Maqedoni



përcaktojnë grupin e gjakut të qytetarëve.

Me disa aktivitete sot do të shënohet 17 Marsi Dita e dhurimit të Gjakut në Republikën e Maqedonisë. Në Qendrën tregtare të qytetit do të vendoset tenda promovuese ku vullnetarët nga Klubi i Kryqit të Kuq i Qytetit të Shkupit dhe “Klub 25” do të ndajnë fletushka dhe do të japin informata për dhurimin e gjakut, ndërsa persona mjekësorë nga Instituti për mjekësi transfuziologjike do të



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sot është shënohet Dita e dhuruesve të gjakut në Maqedoni



Me disa aktivitete sot do të shënohet 17 Marsi Dita e dhurimit të Gjakut në Republikën e Maqedonisë. Në Qendrën tregtare të qytetit do të vendoset tenda promovuese ku vullnetarët nga Klubi i Kryqit të Kuq i Qytetit të Shkupit dhe “Klub 25” do të ndajnë fletushka dhe do të japin informata për dhurimin e gjakut, ndërsa persona mjekësorë nga Instituti për mjekësi transfuziologjike do të përcaktojnë grupin e gjakut të qytetarëve.



Personat me aftësi të kufizuara, perfektë për t'u punësuar në sektorin informatik



Në Javën evropiane të përfshirjes digjitale, Shoqata “Hapni dritaret” dhe MASI ftuan sektorin TI të mendojë më shumë për punësimin e këtyre personave.

“Në Maqedoni, personat me pengesa në zhvillim zakonisht punësohen në vende pune të izoluar, që nuk ndihmojnë në zhvillimin e tyre social. Edhe pse në kohët e fundit ka përparim të ndjeshëm, ne propozojmë masën e punësimit praktik, si mjet real për zhvillimin e kapaciteteve dhe punësimin e tyre në vende reale pune, sidomos në sektorin e teknologjive informative”-deklaroi drejtoresha në MASI, Anita Nikova.

Nga Ministria e Informatikës theksuan se këta persona nuk duhet të diskriminohen dhe ata që i diskriminojnë duhet të dënohen.

“Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet që të diskriminohen në asnjë rast. Janë persona që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje”- tha ministrja e Informatikës, Marta Tomovska-Arsovska.

Sipas Agjencisë për Punësim në Maqedoni, numri i personave me aftësi të kufizuara që kanë një vend pune është rreth 3860, por ata nuk evidentohen si persona me pengesa, por si gjithë të tjerët.